

Në deklaratën e tij të bërë në qytetin bregdetar Brufut të vendit të Afrikës Perëndimore, Gambia, Presidenti i vendit, Yahya Jammeh ka theksuar se: "Fati i Gambias është në duart e Zotit. Prej sot Gambia është një Shtet Islam. Do të jemi një Shtet Islam që respekton të drejtat e qytetarëve tonë".

Deklarata e Jammeh-ut, i cili është presidenti i Gambias që nga viti 1994, është publikuar në faqen e internetit të Presidencës së vendit.

Sipas shifrave zyrtare, 90 përqind të 1,5 milion banorëve të këtij shteti janë muslimanë.

Sipas lajmeve të mediave lokale, presidenti ka theksuar se shpallja e "Shtetit Islam" nuk do të mbulojë me hije lirinë e pakicave në vend.

Gjithashtu u njoftua se presidenti Jammah ka theksuar se të krishterët në Gambia do të vazhdojnë të përmbushin adhurimet e tyre fetare dhe ai nuk do të lejojë që shpallja e "Shtetit Islam" të përdoret për kufizim e veshjes së grave në vend.

Në Afrikë kohë më parë "Shtet Islam" ishte shpallur edhe Mauritania.